



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA VLORE



UNIVERSITETI I VLORËS
"ISMAIL QEMALI"

Nr. 2004 Prot, Datë 12.12 2024

Nr. 2853 Prot, Datë 06.12 2024

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE
DHE
BASHKISË VLORE**

**Neni 1
Baza Ligjore**

Kjo Marrëveshje bazohet në nenin 3, pika 4, gërma c) të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë",

**Neni 2
Qëllimi**

Duke shprehur vullnetin e përbashkët për bashkëpunim në frymën e partneritetit të dy institucionet bien dakord nëpërmjet këtij memorandum si vijon:

- Për shkëmbimin e informacionit dhe bashkërendimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike me qëllim realizimin e të mirave publike.
- Shkëmbimit të përvojave dhe aplikime në shkrimin dhe aplikimin e projekteve
- Koordinimin për angazhim të përbashkët në shkëmbimin e informacioneve lidhur me thirjet për financim nga donator vendas dhe të huaj
- Ndihmë dhe bashkëpunim reciprok për ngritjen dhe aftësimin e kapaciteteve njerëzore
- Pjesëmarrje e përbashkët në konsorciumet e projekteve dypalëshe dhe ndërkombëtare
- Në kuadër të projektit "Vlora Smart City" Bashkia duhet të vendosi në dispozicion:
 - o të dhëna të tilla si: të dhëna demografike të qytetit të Vlorës, të dhëna mbi ndotjen e ajrit/ujit, akustike, të dhëna mbi trafikun e automjeteve në rrugët kryesore/dytësore të qytetit të Vlorës, të dhëna mbi konsumin e energjisë elektrike,



ujit të pishëm etj.

- Të caktojë një grup pune me specialistë në bashkëpunim me grupin e punës së këtij projekti nga UV me qëllim gjetjen dhe gjenerimin e këtyre të dhënave.
- Në përfundim të projektit Bashkia do të përfitojë akses në vizualizimin e të dhënave në Simulatorin Vlora Smart City.

Neni 3 **Detyrimet e palëve**

Palët bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshme nga secili institucion. Bashkëpunimit në fushat e mësipërme realizohet nga personi i ngarkuar me urdhër të Rektorit.

Neni 4 **Konfidencialiteti**

Aktivitetet e kryera në pajtim me këtë Marrëveshje, në mënyrë të veçantë për ndarjen e informacionit dhe pjesëmarrjen në veprime të përbashkëta, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin rregullues të Palëve.

Palët bien dakord të ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni ose materiali të siguruar nga njëra palë për palën tjetër. Ato në pajtim me këtë Marrëveshje nuk do të bëjnë të njohur asnjë informacion ose material të tillë për një palë të tretë pa autorizimin paraprak të palës tjetër.

Neni 5 **Zgjidhja e mosmarrëveshjes**

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga përmbushja e angazhimeve të marra përsipër në këtë Marrëveshje. Nëse njëra prej palëve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Neni 6 **Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 3 (tre) vjeçare nga data e nënshkrimit.
2. Mosrinovimi i kësaj Marrëveshje bëhet nëpërmjet kornunikimit zyrtar nga Universiteti i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.
3. Kjo Marrëveshje hartohet në 4(katër) kopje në gjuhën Shqipe dhe pasi lexohet, firmoset nga Palët përkatëse.

PËR

UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTOR

Prof. Dr. AURELA SALIAJ



PËR

BASHKINË VLORE

KRYETARI

ERMAL DREDHA

